



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS

Numri i Ceshtjes : 71041-02495-11-2019
Numri i Vendimit: 11-2019-7068

Data e Regjistrimit : 02/10/2019
Data e Vendimit : 16/12/2019

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS E PËRBËRË NGA:

GJYQTAR: Eda Kaja
SEKRETARE: Mimoza Cani

Sot më datë 16/12/2019mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen penale që i përket :
Kërkues Shoqëria S h GMB

Në seancën gjyqësore të datës 16.12.2019, të zhvilluar në prani të përfaqësuesit të kërkuesit Av.Albana Tushe, Prokurore Enkeleda Xhengo dhe personi interesuar Gj s, gjykata pasi shqyrtoi në tërësi rrethanat e çështjes, çmoi dhe vlerësoi në tërësi provat e marra deri tani në seancë gjyqësore nënshtruar rregullave të gjykimit si dhe dëgjoi kërkesat e palëve, të cilat kërkuan:

Përfaqësuesja e kërkuesit:

- Heqjen e sekuestros preventive.

Prokuroria:

- Pranimin e kërkesës.

Personi interesuar:

- Rrëzimin e kërkesës

Konkluzioni:

Vëren:

Se *****ka regjistruar procedimin penal Nr_465 per veprën penale të ‘‘Mashtrimi ne pasoja të rënda’’ të parashikuar nga neni 143/3 të K.Penal.

Dhe nga hetimet e kryera del se:

Se ne datë 05.03.2018 shtetasja Gj s ka depozituar një kallëzim penal ndaj shtetasve Mf etj për veprën penale te ‘‘Mashtrimi në pasoja të rënda’’ të parashikuar nga neni 143/3 i K.Penal. Konkretisht ne kallzimin e saj ajo ka sqaruar se ka depozituar një kallzim penal ndaj shtetasve Olicer ***** , Frank Manfred Stiehl, ***** ***** GMBH dhe shoqërisë përmbarimore ‘‘Stf service pasi shoqëria ‘‘Scholtz *****‘‘ GMB aktualisht me disa administratore ku mesa di ajo e ka blere nje shoqëri kineze emrin e te cilës nuk e di. Më parë kjo shoqëri ka qënë quajtur shoqëria ,‘ Scholtz AG‘‘ ku kjo shoqëri ka pasur administrator dhe ortak të vetem shtetasin Oliver Scholtz. Ne vitin 2008 kjo shoqëri ka hapuar nje filial ne Shqipëri që quhej ,‘Scholtz ,‘SH.P.K me

administrator te vetem shtetasin Rado Brajovic me shtetësi serbe dhe nje shtetas tjetër po shtetas serb me emrin Branislav Pejovic. Me vendim te asamblese të datës 01.11.2013 është caktuar ajo si administratore dhe është larguar shtetasi Arsim Muja i cili ishte administrator i kësaj shoqërie. Pas caktimit si administratore ajo ka menduar që të hynte si ortakë ne kete shoqëri ku në momentin që ishte caktuar si administratore shoqëria ishte ne prag falimentimi. Si rezultat i punës që ka kryer ka arritur të ndryshoje gjendjen ekonomike te shoqërisë ta kalonte ne deficit ne bilance pozitive. Takimi i pare me shoqërinë "SC" Sh.p.k eshte bere nga bashkeshorti i saj DS dhe ajo dhe ai janë bërë ortakë të shoqëris SC Sh.p.k me respektivisht ne 25% të aksioneve ku ata kanë blere ne date 17.04.2014 ku dhe është marrë vendim nga asambleja për shitjen e aksioneve. Ata kanë bërë depozitim e këtyre akteve nje vit me vonese ne QKB-Tiranë. Në vitin 2011 kompania kroate "Cios Group" me përfaqëues (administrator) Peter Pripuz dhe nje nder ortakët e shoqërisë i kanë dhene shumën e 6-milion euro borxh shoqërisë Scholts *****- kompanise meme ne Gjermani në vitin 2011 ku shoqëria "Scoltz Albania" SH.P.K ku selia e shoqërisë në këtë periudhe kohe ka qënë në Shkodër, ka qënë garanci për shlyerjen e këtij borxhi ne vite sipas parashikimeve që janë bërë në kontratën e datës 14.02.2012 ku kanë firmosur për shoqërinë shqiptare Branislav Pejovic (administratori i shoqërisë) për C.I.O.S Petar Pripuz dhe për shoqërinë mëmë Raphael Cledmes barth.

Në këtë periudhe kohe ata janë takuar me Z. Peter Pripuz i cili është ortaku i Cios Zagreb, i cili ju ka shpjeguar projektin dhe investimin që kishte bërë në Shqipëri dhe situatën e veshtire në të cilën ndodhet shoqëria ***** Sh.p.k Albania dhe rezultate negative të bilanceve vite me rradhe. Në atë takim Z. Peter Pripuz ju ka kërkuar që të shkonin dhe të shikonin gjendjen e shoqërisë ***** Sh.p.k nga afër dhe nëse kishte ndonjë mundësi për ta aktivizuar biznesin e tyre të falimentuar.

Mbas takimit që kanë bërë në Qeshor të 2013 gjate gjithë kohës kanë qënë në kontakt dhe kanë pasur akses për tu futur në kompani dhe për të shikuar situatën në të cilën ndodhet shoqëria dhe për të parë se çfare mundet të bënin për ta nxjerre shoqërin nga ajo situatë e keqe financiare në të cilën ka qënë dhe aktivite pothuajse zero. Në atë muaj kanë lidhur 2 kontrata bashkepunimi për ta ringjallur firmën ***** Sh.p.k . Me datë 20.11.2013 Menaxheret e Cios Grup Zagreb kane organizuar takimin me ortakun e shoqërisë ***** shpk Albania Z. Oliver ***** dhe investitorin Z. Peter Pripuz i cili është edhe ortak i Cios Grup Zagreb, si edhe me Menaxheret e Cios Grup Zagreb Znj. Iva Pripuz, Znj. Tajan Tomasevic, Znj. Kristina Kerpina dhe Z. DS dhe Znj. Gj s. Një ndër pikat kryesore të mbledhjes ka qënë rregullimi i bilancit dhe zhvillimi i shoqërisë në Shqipëri ***** Sh.p,k Albania.

Në atë takim Gjovanës i është propozuar administrimi i shoqërisë ***** Sh.p.k Albania të cilin e ka pranuar. Në datë 22.11.2013 është marrë vendimi i Asamblesë ku është caktuar administratore e Shoqërisë ***** Sh.p.k dhe në datë 06.12.2013 ka qene Administratore në zyrat e shoqërisë ***** shpk e Rregjistruar në Rregjistrin Kombëtar të Rregjistrimit të shoqërisë "*****" shpk.Ku gjatë kesaj kohe ka punuar intensivisht dhe bashkepunuar njekohesisht me disa firma të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe jashtë saj , ku është arritur të nxirret bilanci vjetor pozitiv pasi ishte vitit i tretë radhazi ku firma dilte me bilanc negativ. Shoqëria ***** shpk shkonte drejt falimentimit në baze të ligjive për shoqëritë tregtare në Republikën e Shqipërisë.Gjate gjithë kohës kanë qënë në kontakt dhe i kanë informuar për punën dhe rezultatet pozitive që kanë arritur në një periudhe të shkurter ku kanë shpetuar firmën nga falimenti. Ku me 21.12.2013 është zhvilluar seminar i shoqërisë ***** AG dhe shoqërive bija në ballkan saktësisht Opatia prefektura E Rijekes Kroaci. Pas prezantimit të arritjeve vjetore të shoqërive bija. Nga aritjet e kenaqeshme te shoqërisë ***** sh.p.k ortaku Oliver ***** dhe investitori Peter Pripuz kanë rezervuar një takim po atë dite ku është ofruar 50% e aksioneve të shoqërisë ***** sh.p.k, me vlere nominale 50000 (pesëdhjetë mijë) lek të reja, por njekohesisht edhe vlerën e kreditit që shoqëria ka, realisht ndaj investitorit Cios Grup Zagreb me vlere 6 milion euro plus interesa sipas kontrates

Në datë 05.02.2014 shtetasi DS i ka kerkuar Z. Oliver ***** ne Mynih të Gjermanise një takim për të detajuar kushtet e bashkepronësise së ***** sh.p.k. Është renë dakord që avokati i tyre të vinte në Shq

iperi për të përgatitur kontratat. Me datë

20.03.2014 në Shqipëri ka ardhur avokat Z. Phillip Dubsky i dërguar nga ***** AG për të hartuar kontrata dhe dokumenta bazuar në marrveshjen e takimit që kemi bërë në Mynih te Gjermanis me Z.Oliver ***** , ku Z, Dubsky ka përgatitur kontraten e shitblerjes se kuaotave (ku ne kemi blere 50% të kuotave të shoqërisë) dhe vendimin e Asambles ku janë firmosur nga ortaku i ***** sh.p.k dhe janë noterizuar në Gjermani me date 17.04.2014. Ne blerjen e këtyre aksioneve kanë paguar shumën e 50.000-leke të vlerës së kapitalit dhe blerjes së borxhit prej 6-milion euro nga C.I.O.S-Group Zagreb se bashku me interes përkatëse (sipas bilancit që kishte shoqëria në atë moment). Dubsky i është venë në dijeni që kontrata të ketë fuqi ligjore për shoqëritë Tregtare në Republikën e Shqipërisë kontrata duhet të jenë të noterizuar dhe me vule apostile nga shteti Gjerman. Ai është kthyer në Gjermani dhe ka ardhur në Shqipëri në datë

29.04.2014 për të firmosur të gjitha dokumentat të cilat kanë qenë pjesë e transaksionit Join Venture ***** dhe Sokolaj në Shqipëri. Me dokumentat e tij ata kanë shkuar tek noter Fatmir Laçi ku mungonte vula apostile në autorizimin e përfaqësuesit. Ai është larguar për në Gjermani dhe nuk i ka sjelle me dokumentat me vule apostile. Dhe pas këtij momenti në nëntor të 2014 janë takuar në zyrat e shoqërisë ***** sh.p.k me Z.Oliver ***** dhe Z.Peter Pripuz ku është ofruar të shitet 100% ***** sh.p.k tek Sokolaj shpk pasi ***** holding ishte në problem financiare . Kanë negociuar për muaj me rradhe por nuk kanë arritur një marrveshje sepse njëkohësisht në fshehtësi me administratorin e dytë të shoqërisë Blaze Mitrevski po kontaktonin firma të tjera në Shqipëri për ta shitur pa dijeninë e tyre. Në datë 30.06.2015 janë takuar në hotel ‘Rogner Tirane me Z.Oliver ***** ku i kanë thënë se nëse donte që të shitej në subjekte të tjerë nuk është e nevojshme të behehsin prapaska me lloj-lloj njerezish por të ulëshin të mbyllim llogarinë që kishin dhe ti likudionte dhe do të largoheshim ata të parët. Keshtu e lanë që ai të vinte në zyrën e shoqërisë ***** sh.p.k për 1 orë, por ai si gjithmonë nuk ju përmbajt marrveshjes dhe bëri të kundërtën , e ka shkarkuar nga detyra e administratorit dhe emëroj Blaze Mitrevskin si administrator i vetëm i shoqërisë. Në datë 03.07.2015 është depozituar në QKB vendimi I asamblesë ku ligjërisht ajo duhej të ishte njoftuar por nuk është njoftuar dhe pas këtij momenti është paraqitur në zyrat e shoqërisë ***** sh.p.k që ndodhen në ‘Xhafzotaj—Durrës shtetasi Blaze Mitrevskin si administrator i shoqërisë me kompetenca të pakufizuara. Gjovana i ka bërë me dije si atë dhe avokatin Neritan Kallfa që shoqëria është me bashkeortak dhe mos të marrin asnjë hap pa mbyllur mosmarrveshjet mes nesh, dhe i kanë vënë dispozicion dhe kontratën e shitblerjes dhe vendimin e asamblese se ortakëve. Por në mënyrë arrogante nuk është marrë për bazë nga zoterinjtë në fjale duke urdheruar edhe rojet e shoqërisë që mos i lejonin hyrjen në kompani. Në atë moment ka paraqitur kontratën në QKR për regjistrim ku është aprovuar nga QKR dhe është pasqyruar në historikun e shoqërisë në datë 24.07.2015. Pas këtij momenti kanë ankimuar rregjistrimin e kontratës së shitet-blerjes dhe vendimin e ortakëve me pretendimin sepse paraqitur nga personi jo i autorizuar nga administrator i shoqërisë . QKR-ja e ka pranuar ankimin peserisht në lidhje me blerjen e kuotave nuk e ka ndryshuar e ka lënë të mirëqënë pra ajo dhe bashkëshorti I saj janë aksioniere në 50% të kuotave ndërkohe nuk ka pranuar të ndryshonte emrin e shoqërisë nga ‘Scholtz ‘ në ‘Scholtz & Sokolaj’ Group ku vendimi është I datës 03.08.2015. Administratori Blaze Mitrevski ka bërë kërkesë padi në Gjykatën Administrative Tirane. Padites ;***** sh.p.k ‘***** Internationale Handelsgesellschaft’, i paditur ; QKR Pale e tretë; Gj s , ku gjykata me vendimin e saj e ka pranuar kërkesë-padine pasi ka arsyetuar se dokumentat shoqëruese të aplikimit të cilat duhet të provojnë të dhëna që rregjistrohen në këtë numër çështje nuk plotësojnë kushtet e nenit 27 i ligjit nr 9723, janë akte të palegalizuara pasi mungonte vula apostile. Ata e kanë ankimuar këtë vendim dhe ky vendim është lënë në fuqi. Pas këtij

veprimi ortaku ‘***** INTR’ GmbH ka marrë vendim marrjen të njëanshme ku ka vendosur administrator të shoqërisë SC SH.P.K Zotin. **Frank Manfred Stiehl** . Ndërkohe në datë 16.03.2016 ajo e ka legalizuar kontratën duke i vendosur vulen apostile (legalizuar) në ambasadën tone në Berlin-Gjermani dhe me pas e kanë dorëzuar në QKR në datë 22.06.2016 ku dhe është rregjistruar.

Më kontratën e premtim pagese te datës 12.07.2016 shtetasi gjerman Mf përpara noter Laura Pustina, me cilësinë e përfaqësuesit të shoqërisë "***" SH.P.K me Nipt K 86625002 F firmos nje premtim pagese ku pasqyrohet fakti se premtim pagimin e shumë prej 3.803.788.69- euro shoqërisë ***** Holdigng-GmBmG (ish Schloz AG) si borxh referuar marrëveshjes së kredisë me Nr 1241 (e ndryshuar ne kredine llogarie Nr 12105), me synim per te shpalle falimentimin e provokuar . Nëse i referohemi kësaj kredie që është cituar në premtimin e pagesës kjo kredi është likuduar nga C.I.O.S-Group-Zagreb ne date 14.02.2012 dhe ndërkohe detyrimin e C.I.O.S na e ka shitur ne momentin që kemi blere aksionet. Më pas këtë premtim pagese e kanë dorëzuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane ku është nxjerrë urdher ekzekutim Nr 6415 akti date .21.10.2016 nga Gjyqtar Bledar Abdullahi. Përfaqësues i kësaj shoqërie ka qënë avokate Albana Tushe dhe ne kete moment Gjovana ka ardhur ne dijeni që është transferuar qendra e shoqërisë nga Shtugart-Gjermani ne Londer-Angli . Pra vendimi i gjykatës për lëshimin e urdherit te ekzekutimit është bërë për shoqërinë me qëndër në Londer-Angli dhe ndërkohe premtim pagesa është bërë për shoqërinë me qëndër ne Gjermani pra dy subjekte te ndryshme tregtare. Urdheri i ekzekutimit është dërguar për tu ekzekutuar nga përmbaruesi gjyqësor "Strati Bailiff Service" SH.P.K dhe na e ka sjelle ne për ekzekutim si aksionier ne 50% të shoqërisë. Veprimet përmbarimore ajo i ka ankimuar si administratore e shoqërisë dhe janë ne proces gjyqësor aktualisht nuk ka marë vendim dhe gjyqtare e cështjes është Mimoza Margjeka. Përmbaruesi gjyqësor ne vitin 2017 ka shpallur ankand për shitjen e pasurive ku ata e kanë kundërshtuar ne gjykate dhe e ka pranuar gjykata me vendimin Nr 2066 date 14.12.2017 i cili është lënë në fuqi të Gjykatën e Apelit Durrës. Më pas në datë 31.08.2018 i ka nxjerrë në ankand me qëllim shitjen e tyre dhe është shpallur fitues shoqëria "Scholtz *****" GMBH (Ish ***** AG). Pra vete kreditori është shpallur fitues i ankandit. Me procesverbalin e kqyrjes dhe marrjes të provës materiale te datës 07.03.2019 janë administruar nga ZRPP-Durrës praktika e mabtur ne lidhje me rregjistrimin e pasurive nga shoqëria "SC "SH.P.K ne atë me emer te shoqërisë "SC HOLDING" GMBH. Apolikues për këtë rregjistrim rrezulton shtetasit Albi Halili, terheqesë e cerifikatavë të proneisse reuzlotn shtetasja Marisa Nito dhe asnjeri prej tyre nuk reuzlotn se ka apsur autoriizm nga shoqëria "SC *****" G.M.G.H. nga heitmet ka reuzltuar se rregjistrimi i pronesisë është bërë për nje shoqëri tregtare te huaj e cila nuk ka qëndër të rregjistruar në Shqipëri si dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë nuk është dërguar shkresa mbi bazën e te cilës rezultonte shoqëria "SC" SH.P.K debitore apo jo.**

Në datë 05.03.2018 shtetasja Gj s ka depozituar një kallëzim penal ndaj shtetasve Mf etj për veprën penale te "Mashtrimi në pasoja të rënda" të parashikuar nga neni 143/3 i K.Penal. Konkretisht ne kallëzimin e saj ajo ka sqaruar se ka depozituar një kallëzim penal ndaj shtetasve Olicer ***** , Frank Manfred Stiehl , ***** ***** GMBH dhe shoqërisë përmbarimore , 'Stf service pasi shoqëria , 'Scholtz *****' GMB aktualisht me disa administratore ku mesa di ajo e ka blere nje shoqëri kineze emrin e te cilës nuk e di. Më parë kjo shoqëri ka qënë quajtur shoqëria , ' Scholtz AG' ku kjo shoqëri ka pasur administrator dhe ortak të vetem shtetasin Oliver Scholtz. Ne vitin 2008 kjo shoqëri ka hapuar nje filial ne Shqipëri që quhej , 'Scholtz , 'SH.P.K me administrator te vetem shtetasin Rado Brajovic me shtetësi serbe dhe nje shtetas tjetër po shtetas serb me emrin Branisllav Pejovic. Me vendim te asamblese të datës 01.11.2013 është caktuar ajo si administratore dhe është larguar shtetasi Arsim Muja i cili ishte administrator i kësaj shoqërie. Pas caktimit si administratore ajo ka menduar që të hynte si ortake ne kete shoqëri ku në momentin që ishte caktuar si administratore shoqëria ishte ne prag falimentimi. Si rezultat i punës që ka kryer ka arritur të ndryshoje gjendjen ekonomike te shoqërisë ta kalonte ne deficit ne bilance pozitive. Takimi i pare me shoqërinë "SC" Sh.p.k eshte bere nga bashkeshorti i saj DS dhe ajo dhe ai janë bërë ortake të shoqëris SC Sh.p.k me respektivisht ne 25% të aksioneve ku ata kanë blere ne date 17.04.2014 ku dhe është marrë vendim nga asambleja për shitjen e aksioneve. Ata kanë bërë depozitimimin e këtyre akteve nje vit me vonese ne QKB-Tiranë. Në vitin 2011

kompania kroate "Cios Group" me përfaqësues (administrator) Peter Pripuz dhe një ndër ortakët e shoqërisë i kanë dhënë shumën e 6-milion euro borxh shoqërisë Scholts *****- kompanisë meqenëse në Gjermani në vitin 2011 ku shoqëria "Scoltz Albania" SH.P.K ku selia e shoqërisë në këtë periudhë kohe ka qënë në Shkodër, ka qënë garanci për shlyerjen e këtij borxhi në vite sipas parashikimeve që janë bërë në kontratën e datës 14.02.2012 ku kanë firmosur për shoqërinë shqiptare Branislav Pejovic (administratori i shoqërisë) për C.I.O.S Petar Pripuz dhe për shoqërinë mëmë Raphael Cledmes barth.

Në këtë periudhë kohe ata janë takuar me Z. Peter Pripuz i cili është ortak i Cios Zagreb, i cili ju ka shpjeguar projektin dhe investimin që kishte bërë në Shqipëri dhe situatën e vështirë në të cilën ndodhesh shoqëria ***** Sh.p.k Albania dhe rezultate negative të bilanceve vite me rradhë. Në atë takim Z. Peter Pripuz ju ka kërkuar që të shkonin dhe të shikonin gjendjen e shoqërisë ***** Sh.p.k nga afër dhe nëse kishte ndonjë mundësi për ta aktivizuar biznesin e tyre të falimentuar.

Mbas takimit që kanë bërë në Qeshor të 2013 gjatë gjithë kohës kanë qënë në kontakt dhe kanë pasur akses për tu futur në kompani dhe për të shikuar situatën në të cilën ndodhet shoqëria dhe për të parë se çfarë mundet të bënin për ta nxjerre shoqërinë nga ajo situatë e keqe financiare në të cilën ka qënë dhe aktiviteti pothuajse zero. Në atë muaj kanë lidhur 2 kontrata bashkëpunimi për ta ringjallur firmën ***** Sh.p.k . Me datë 20.11.2013 Menaxheret e Cios Grup Zagreb kanë organizuar takimin me ortakun e shoqërisë ***** shpk Albania Z. Oliver ***** dhe investitorin Z. Peter Pripuz i cili është edhe ortak i Cios Grup Zagreb, si edhe me Menaxheret e Cios Grup Zagreb Znj. Iva Pripuz, Znj. Tajan Tomasevic, Znj. Kristina Kerpina dhe Z. DS dhe Znj. Gj s. Një ndër pikat kryesore të mbledhjes ka qënë rregullimi i bilancit dhe zhvillimi i shoqërisë në Shqipëri ***** Sh.p,k Albania.

Në atë takim Gjoanës i është propozuar administrimi i shoqërisë ***** Sh.p.k Albania të cilin e ka pranuar. Në datë 22.11.2013 është marrë vendimi i Asamblesë ku është caktuar administratori e Shoqërisë ***** Sh.p.k dhe në datë 06.12.2013 ka qënë Administratori në zyrat e shoqërisë ***** shpk e Rregjistruar në Rregjistrin Kombëtar të Rregjistrimit të shoqërisë "*****" shpk. Ku gjatë kësaj kohe ka punuar intensivisht dhe bashkëpunuar njëkohësisht me disa firma të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe jashtë saj , ku është arritur të nxirret bilanci vjetor pozitiv pasi ishte vitit i tretë radhazi ku firma dilte me bilanc negativ. Shoqëria ***** shpk shkonte drejt falimentimit në baze të ligjive për shoqëritë tregtare në Republikën e Shqipërisë. Gjatë gjithë kohës kanë qënë në kontakt dhe i kanë informuar për punën dhe rezultatet pozitive që kanë arritur në një periudhë të shkurtër ku kanë shpetuar firmën nga falimenti. Ku me 21.12.2013 është zhvilluar seminar i shoqërisë ***** AG dhe shoqërive bija në ballkan saktësisht Opatia prefektura E Rijekes Kroaci. Pas prezantimit të arritjeve vjetore të shoqërive bija. Nga aritjet e kenaqëshme të shoqërisë ***** sh.p.k ortak i Oliver ***** dhe investitori Peter Pripuz kanë rezervuar një takim po atë ditë ku është ofruar 50% e aksioneve të shoqërisë ***** sh.p.k, me vlerë nominale 50000 (pesëdhjetë mijë) lek të reja, por njëkohësisht edhe vlerën e kreditit që shoqëria ka, realisht ndaj investitorit Cios Grup Zagreb me vlerë 6 milion euro plus interesat sipas kontratës

Në datë 05.02.2014 shtetasi DS i ka kërkuar Z. Oliver ***** në Mynih të Gjermanisë një takim për të detajuar kushtet e bashkëpunimit të ***** sh.p.k. Është rënë dakord që avokati i tyre të vinte në Shqipëri për të përgatitur kontratat. Me datë

20.03.2014 në Shqipëri ka ardhur avokat Z. Phillip Dubsky i dërguar nga ***** AG për të hartuar kontratën dhe dokumenta bazuar në marrëveshjen e takimit që kemi bërë në Mynih të Gjermanisë me Z. Oliver ***** , ku Z. Dubsky ka përgatitur kontratën e shitblerjes së kuotave (ku në kemi blerë 50% të kuotave të shoqërisë) dhe vendimin e Asamblesë ku janë firmosur nga ortak i ***** sh.p.k dhe janë noterizuar në Gjermani me datë 17.04.2014. Në blerjen e këtyre aksioneve kanë paguar shumën e 50.000-leke të vlerës së kapitalit dhe blerjes së borxhit prej 6-milion euro nga C.I.O.S-Group Zagreb së bashku me interesat përkatëse (sipas bilancit që kishte shoqëria në atë moment). Dubsky i është venë në dijeni që kontrata të ketë fuqi ligjore për shoqëritë tregtare në Republikën e Shqipërisë kontrata duhet të jenë të noterizuar dhe me vullnet apostilë nga shteti Gjerman. Ai është

ë kthyer ne Gjermani dhe ka ardhur ne Shqipëri në datë

29.04.2014 për të firmosur të gjitha dokumentat të cilat kanë qenë pjese e transaksionit Join Venture ***** dhe Sokolaj në Shqipëri. Me dokumentat e tij ata kanë shkuar tek noter Fatmir Laçi ku mungonte vula apostile ne autorizimin e përfaqësuesit. Ai është larguar për në Gjermani dhe nuk I ka sjelle me dokumentat me vule apostile. Dhe pas ketij momenti në nentor të 2014 janë takuar në zyrat e shoqërisë ***** sh.p.k me Z.Oliver ***** dhe Z.Peter Pripuz ku është ofruar te shitet 100% ***** sh.p.k tek Sokolaj shpk pasi ***** holding ishte në problem financiare . Kanë negociuar për muaj me rradhe por nuk kanë arritur një marreveshje sepse njëkohesisht në fshehtësi me administratorin e dytë të shoqëris Blaze Mitrevski po kontaktonin firma të tjera në Shqipëri për ta shitur pa dijenine e tyre. Në datë 30.06.2015 janë takuar në hotel ‘Rogner Tirane me Z.Oliver ***** ku I kanë thenë se nëse donte qe të shitej në subjekte te tjerë nuk është e nevojshme të behehsin prapaskena me lloj-lloj njerezish por të uleshin të mbyllnim llogarine që kishin dhe ti likudionte dhe do të largoheshim ata të parët. Keshtu e lanë që ai të vinte në zyren e shoqërisë ***** sh.p.k për 1 ore, por ai si gjithmon nuk ju permbajt marreveshjes dhe beri të kunderten , e ka shkarkuar nga detyra e administratorit dhe emëroj Blaze Mitrevskin si administrator I vetem I shoqërisë. Në datë 03.07.2015 është depozituar në QKB vendimi I asamblesë ku ligjerisht ajo duhej te ishte njoftuar por nuk është njoftuar dhe pas ketij momenti është paraqitur në zyrat e shoqëris ***** sh.p.k që ndodhen ne ‘Xhafzotaj—Durrës shtetasi Blaze Mitrevskin si administrator I shoqërisë me kopetenca të pakufizuara. Gjovana i ka bërë me dije si atë dhe avokatin Neritan Kallfa që shoqëria është me bashkeortak dhe mos te marrin asnje hap pa mbyllur mosmarreveshjet mes nesh, dhe I kanë vënë dizpozicon dhe kontratën e shitetblerjes dhe vendimin e asamblese se ortakve. Por në menyre arrogante nuk është marre për baze nga zoterinjte në fjale duke urdheruar edhe rojet e shoqërisë që mos i lejonin hyrjen në kompani. Në ate moment ka paraqitur kontraten në QKR për regjistrim ku është aprovuar nga QKR dhe është pasqyruar ne historikun e shoqërisë në datë 24.07.2015. Pas ketij momenti kane ankimuar rregjistrimin e kontrates së shitet-blerjes dhe vendimin e ortakëve me pretendimin sepse paraqitur nga personi jo I autorizuar nga administrator I shoqërisë . QKR-ja e ka pranuar ankimin peserisht në lidhje me blerjen e kuotave nuk e ka ndryshuar e ka lënë të mirëqënë pra ajo dhe bashkëshorti I saj janë aksioniere ne 50% të kuotave nderkohe nuk ka pranuar të ndryshonte emrin e shoqërisë nga ‘Sc

‘ ne ‘Scw & Sow’ Group ku vendimi është I datës 03.08.2015. Administratori Blaze Mitrevski ka bere kerkes padi ne Gjykatën Administrative Tirane. Padites ;***** sh.p.k ‘***** Internationale Handelsgesellschaft’, i paditur ; QKR Pale e tretë; Gj s , ku gjykata me vendimin e saj e ka pranuar kërkesë-padine pasi ka arsyetuar se dokumentat shoqëruese të aplikimit të cilat duhet të provojnë të dhëna që rregjistrohen në këtë numër çështje nuk plotësojnë kushtet e nenit 27 i ligjit nr 9723, janë akte të palegalizuara pasi mungonte vula apostile. Ata e kanë ankimuar këtë vendim dhe ky vendim është lënë në fuqi. Pas ketij veprimi ortaku ‘***** Internationale Handelsgesellschaft’ GmbH ka marre vendimmarrjen te njeanshme ku ka vendosur administrator te shoqëris SC SH.P.K Zotin. **Frank Manfred Stiehl** . Ndërkohe në datë 16.03.2016 ajo e ka legalizuar kontratën duke i vendosur vulen apostile (legalizuar) në ambasadën tone ne Berlin-Gjermani dhe me pas e kanë dorëzuar në QKR në datë 22.06.2016 ku dhe është rregjistruar.

Më kontratën e premtim pagese te datës 12.07.2016 shtetasi gjerman Mf përpara noter Laura Pustina, me cilësinë e përfaqësuesit te shoqërisë ‘**’ SH.P.K me Nipt K 86625002 F firmos nje premtim pagese ku pasqyrohet fakti se premtion pagimin e shumës prej 3.803.788.69- euro shoqërisë ***** Holdigng-GmBmG (ish Schloz AG) si borxh referuar marrëveshjes së kredisë me Nr 1241 (e ndryshuar ne kredine llogarie Nr 12105), me synim per te shpalle falimentimin e provokuar. Nëse i referohemi kësaj kredie që është cituar në premtimin e pagesës kjo kredi është likuduar nga C.I.O.S-Group-Zagreb ne date 14.02.2012 dhe ndërkohe detyrimin e C.I.O.S na e ka shitur ne momentin që kemi blere aksionet. Më pas këtë premtim pagese e kanë dorëzuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane ku është***

nxjerrë urdher ekzekutim Nr 6415 akti date .21.10.2016 nga Gjyqtar Bledar Abdullai. Përfaqësues i kësaj shoqërie ka qënë avokate Albana Tushe dhe ne kete moment Gjovana ka ardhur ne dijeni që është transferuar qendra e shoqërisë nga Shtugart-Gjermani ne Londer-Angli . Pra vendimi i gjykatës për lëshimin e urdherit te ekzekutimit është bërë për shoqërinë me qëndër në Londer-Angli dhe ndërkohe premtim pagesa është bërë për shoqërinë me qëndër ne Gjermani pra dy subjekte te ndryshme tregtare. Urdheri i ekzekutimit është dërguar për tu ekzekutuar nga përmbaruesi gjyqësor “Strati Bailiff Service” SH.P.K dhe na e ka sjelle ne për ekzekutim si aksionier ne 50% të shoqërisë. Veprimet përmbarimore ajo i ka ankimuar si administratore e shoqërisë dhe janë ne proces gjyqësor aktualisht nuk ka marë vendim dhe gjyqtare e çështjes është Mimoza Margjeka. Përmbaruesi gjyqësor ne vitin 2017 ka shpallur ankand për shitjen e pasurive ku ata e kanë kundërshtuar ne gjykate dhe e ka pranuar gjykata me vendimin Nr 2066 date 14.12.2017 i cili është lënë në fuqi të Gjykatën e Apelit Durrës. Më pas në datë 31.08.2018 i ka nxjerrë në ankand me qëllim shitjen e tyre dhe është shpallur fitues shoqëria “Scholtz *****” GMBH (Ish ***** AG). Pra vete kreditori është shpallur fitues i ankandit.

Me procesverbalin e kqyrjes dhe marrjes të provës materiale te datës 07.03.2019 janë administruar nga ZRPP-Durrës praktika e mabtjur ne lidhje me rregjistrimin e pasurive nga shoqëria “SC “SH.P.K ne atë me emer te shoqërisë “SC HOLDING” GMBH. Aplikues për këtë regjistrim rezulton shtetasi Albi Halili, terheqëse e certifikatave të pronësisë rezulton shtetasja Marisa Nito dhe asnjeri prej tyre nuk reuzlton se ka pasur autorizim nga shoqëria “SCOLZ *****” G.M.G.H. nga hetimet ka rezultuar se rregjistrimi i pronësisë është bërë për nje shoqëri tregtare te huaj e cila nuk ka qëndër të rregjistruar në Shqipëri si dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë nuk është dërguar shkresa mbi bazën e te cilës rezultonte shoqëria “SC” SH.P.K debitore apo jo.

Nga ana e kerkuesit shoqërisë me data 02.10.2019, është paraqitur në Gjykate kërkesa me objekt: revokimin e masës së sekuestros së vendosur me vendimin Nr 78 datë datë 11.03.2019 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës e cila ka vendosur sekuestro mbi pasuritë e kreditorit ***** GmbH.

Gjykata shqyrtoi me kujdes të gjithë materialet e çështjes dhe konkludon se sekuestroja preventive, në bazë të neneve 274-276 të Kodit të Procedurës Penale, urdhërohet në rastin kur ekziston rreziku që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, apo edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal.

Bazuar në analizën sistematike të dispozitës ligjore, vërehet se sekuestroja preventive mund të urdhërohet për “qëllime të parandalimit” të pasojave apo veprimeve të paligjshme kriminale, në rastet e parashikuara prej pikës “1” të nenit 274 të Kodit të Procedurës Penale, ndërsa në rastet e parashikuara prej pikës “2”, të po këtij neni, sekuestroja preventive mund të urdhërohet për “qëllime të sekuestrimit”, sipas përcaktimeve të parashikuara nga neni 36 i Kodit Penal. Në rastin e dytë, kemi të bëjmë me një “goditje” më efikase të avantazheve ekonomike që vijnë si rezultat i veprimtarive kriminale, dhe masa në fakt merr trajtën e një sanksioni penal.

Kushtet e nevojshme ligjore për caktimin e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive njëkohësisht janë: prania e indicjeve, d.m.th prania e elementit të ashtuquajtur *fumus boni iuris*, si dhe prania e elementit të ashtuquajtur *periculum in mora* [rreziku i vonësës] deri në kalimin e vendimit në gjë të gjykuar.

Sa i takon elementit të *fumus boni iuris*, në bazë të nenit 274 të Kodit të Procedurës Penale, rezulton se për zbatimin e sekuestros preventive, është e nevojshme hetimi dhe marrja e të dhënave dëshmuese rreth kryerjes (së mundshme në të ardhmen e afërt) së një fakti që përbën vepër penale të parashikuar dhe të cilësuar në bazë të një dispozite të Kodit Penal, si dhe verifikimi i faktit të një rëndimi, apo zgjatjeje të pasojës së veprës penale, apo të një lehtësimi të

kryerjes së veprave të tjera penale, në raport me rrethanat dhe veçoritë e faktit konkret të supozuar se është kryer apo do të kryhet.

Objekti i sekuestros preventive përcaktohet shprehimisht në sendet që lidhen me veprën penale të supozuar se është kryer, prandaj lejohet caktimi i masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive, edhe përpara apo gjate verifikimit të faktit nëse është kryer vepra penale. Për këtë arsye, është e nevojshme prania e një sërë indicjeve që lidhin sendin apo pasurinë me natyrën dhe llojin e veprës penale të supozuar nga ana e organit të akuzës në raport edhe me faktet e parashtruara apo të grumbulluara mbi çështjen konkrete. Këto indicje nuk duhet të vlerësohen në mënyrë abstrakte dhe të përgjithshme, Gjithashtu, gjykata e themelit duhet të verifikojë dhe të argumentojë edhe mbi praninë e një sërë indicjeve që krijojnë dyshimin e arsyeshëm se do të arrihet në një vendim dënimi.

Persa i takon pranisë së elementit të *periculum in mora*, ky element përbën vetë qëllimin e nevojshëm për caktimin e kësaj mase mbi pasurinë, pra në shmangien e ardhjes ose zgjatjes së pasojave nga vepra penale apo të lehtësimit të kryerjes së veprave të tjera penale. Në këtë mënyrë, elementi i *periculum in mora*, konsiderohet si një probabilitet realist, që sendi objekt i mundshëm sekuestrimi preventiv, të bëhet shkak rëndues, zgjatës, për veprën penale të supozuar, apo shkak lehtësues për vepra të tjera të supozuara se mund të ndodhin efektivisht. Kjo mbështetur në llojin dhe natyrën e sendit dhe tërësinë e rrethanave konkrete, dhe duke u bazuar në nevoja reale dhe jo gjasa thjesht teorike.

Objekti i sekuestros preventive, sipas pikës “1” të nenit 274 të Kodit të Procedurës Penale, përbëhet nga “sendet që lidhen me veprën penale”, domethënë nga marrëdhënia e krijuar midis sendit dhe veprës penale të kryer, apo me të ardhurat që vijnë si rezultat i kryerjes së veprës penale, po të vazhdojë mbajtja e mëtejshme e sendit. Në këtë rast është e kuptueshme që kemi të bëjmë me një raport midis sendit dhe veprës penale, i cili nuk është i rastësishëm, por i konceptuar dhe vënë në funksion të natyrës së veprës penale.

Në rastin e pikës “2” të nenit 274 të Kodit të Procedurës Penale, objekti i sekuestros përbëhet nga sendet e sekuestrueshme, në kuptim të nenit 36 të Kodit Penal, por të qenit i sekuestrueshëm i sendit, nuk është kusht i vetëm për përligjen e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive, pasi edhe në këtë rast, janë të nevojshme prania e dy këtyre elementëve.

Duke ju kthyer çështjes objekt gjykimi, provohet:

Se sendet luajtshme dhe te paluajtshme te shoqerise qe kerkohen te sekustrohen, i kanë shërbyer apo destinuar për kryerjen e veprës penale, apo se është pikërisht ai që përbën produktin e veprës penale, përdorimi, mbajtja ose tjetërsimi i së cilit, përbën veprën penale.

Gjithashu, provohet ekzistenca e një lidhjeje të posaçme, funksionale dhe jo të rastësishme (domethënë të qëndrueshme) midis sendeve te luajtshme dhe te paluajtshme ne fjale dhe veprimet penal të kundërligjshëm. Në rastin objekt gjykimi provohet qe veprimet kriminale kane filluar prej mëse 4 vitesh dhe vazhdojne, bashke me zgjatjen e pasojave te cituara me sipër.

Per shkaqet e mësipërme, Gjykata vlerëson se kërkesa e bërë nga kërkuesi ***** ***** ***** GMBH nuk është e mbështetur në prova dhe ligj dhe duhet rrëzuar.

Arsyeja:

Baza Ligjore:

Në zbatim të nenit 274, 276 të Kodit Procedures Penale, Gjykata

Vendimi:

Vendosi:

1. Rrëzimin e kërkesës së kërkuetit ***** ***** ***** GMBH, me objekt: Heqja e masës së sekuestros së vendosur me vendimin 78 datë 11.03.2019 të gjykatës së rrethit gjyqësor Durrës.

2. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të kërkuarit

3. Kunder vendimit mund të behet ankim në Gjykatën e Apelit Durrës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) diteve nga e nesërmeja e shpalljes së tij.